

**NEXHAT AGOLLI**  
**RAMAZAN BOGDANI**

## **VALLJA SI SHPREHJE E NDJENJAVE DHE E MENDIMEVE TË GRUAS NË JETËN SHOQËRORE**

Në vallëzimin tonë popullor tradicional ekzistojnë dy lloje të ndryshme kërcimi: vallet e grave dhe vallet e burrave. Ky veçim i valleve simbas seksit është një nga shfaqjet e dasisë dhe e pabarazisë së gruas me burrin, e pasqyruar nëpërmjet artit të kërcimit, zakon ky që na u trashëgua brez pas brezi, ndoshta, që nga ajo kohë për të cilën Engelsi shkruante: «Antagonizmi i parë i klasave në histori vjen në një kohë me zhvillimin e antagonizmit midis burrit dhe gruas në monogami, dhe shtypja e parë klasore bie në një kohë me skllavërimin e seksit femëror nga seksi mashkullor». Ndryshimi i madh midis tyre, i ngritjes së burrit dhe i poshtërimit të gruas, u kushtëzua në vendin tonë, me kalimin e kohës, me ekzistencën dhe veçoritë e sistemit patriarkal e atij feudal. Një dëm të madh solli edhe sundimi shekullor i huaj e mbi të gjitha feja, e cila përligjte në radhë të parë shtypjen e gruas. Kështu pabarazia, skllavërimi shpirtëror i gruas, u bë normë e shoqërisë e bazuar në ndarjen klasore dhe u sanksionua në kanunet e egra të shkruara, edhe në ato të pashkruara, që kaluan heshtazi nga njeri brez në tjetrin.

Në këto kushte jetonte gruaja; megjithatë ajo luftonte. Mbi supet e saj rëndonte një barrë e madhe, e rëndë, ajo duhej të mbante shtëpinë, të rriste fëmijët, ajo ndjente dhe jetonte gëzimet dhe hidhërimet e jetës. Martesa dhe lindja përbënin çastet më të rëndësishme të jetës së saj. Por edhe këto martesa kishin shqetësimet e tyre prapa të cilave fshiheshin ligjet dhe zakonet gjakatare, që e detyronin gruan nga forca e kanunit të pranonte në heshtje «aktin e martesës».

Sa këngë thuri ajo për jetën e saj dhe për dasmat, dhe me këto këngë ajo hodhi edhe vallet në dhomat e mbyllura. Të thjeshta qenë këto këngë, bashkë me to edhe vallet. Struktura dhe përmbajtja e këtyre valleve është rezultat i pasqyrimin të ndjenjave dhe i mendimeve të gruas në jetën e saj shoqërore. Dhe kjo vërehet pikërisht në elementet përbërëse të valles: motivet koreografike, në mënyrën e trajtimit dhe të zhvendosjes së tyre, interpretimin dhe karakterin në përgjithësi. Njëkohësisht, brendia dhe ndërtimi i tyre nuk duhen marrë të shkëputura, por në lidhje të ngushtë me marrëdhënjet shoqërore, që shfaqen edhe në ndryshimet krahinore, ashtu edhe me faktorë të tjerë si: ambjenti gjeografik (terreni), klima, veshja etj.

Nga sa u tha, rezultojnë stile të ndryshme kërcimi:

Së pari: valle që shoqërohen me këngë dhe që karakterizohen nga

një interpretim i qetë, i shtruar dhe me një ritëm të zakonshëm, horizontal nga fillimi e gjer në fund. Si në përmbajtje ashtu edhe në ekzekutim këto valle paraqiten të thjeshta. Valle të tilla luhen kryesisht në pjesën malore dhe pjesërisht në atë fushore të vendit tonë, si p.sh. në fshatrat: Moisit (rr. Tiranës), Shushicë (rr. Elbasanit), Homezh (rr. Pogradecit), Obot (rr. Shkodrës) etj. Disa nga kërcimet e këtij lloji luhen në «rreth të mbyllur». Ekzekutimi i valles në «rreth të mbyllur» është një nga format ritualistike më të vjetra. Sot ato janë larg çdo kuptimi ritualistik dhe praktikohen si kërcime që shprehin një mendim tjetër, lidhur me ceremonialin e dasmës. Shumica e valleve të tjera të këtij lloji luhen në një formacion tjetër, në «gjysëm rrethi të hapur», që i përket — simbas mendimit tonë — një stadi më të vonë.

Së dyti: Valle të shoqëruara me instrumenta popullore (saze), që kanë hyrë prej kohësh, të cilat karakterizohen nga një interpretim dhe përmbajtje plastike më e zhvilluar, gjë që ka rezultuar në inkudrimin e motiveve koreografike dhe në një ekzekutim unison. Kërcimet e këtij karakteri, që luhen në formacion «gjysëm rrethi të hapur», vërehen në pjesën jugore dhe juglindore të vendit. Karakteristike për të (ashtu si edhe për llojin e parë) është ecja e zakonshme (e shprehur herë-herë në aritmi) dhe kryesisht motivi «asimetrik» (katër hapa djathtas, dy majtas), që në disa raste paraqitet i dubluar (zakonisht në hapin e katërt e të gjashtë).

Së treti: Valle që shoqërohen me instrumenta kordeofonë (çifteli) dhe përkusioni (lodër) që, në përgjithësi, shquhen nga një mënyrë e lirë kërcimi «ad libidum» dhe nga një interpretim i gjallë, shpeshherë mahnitës. Vallet e kësaj natyre karakterizohen nga motive të papërcaktuara, por në brendinë e tyre dallojmë edhe motive më të thjeshta «dyshe», që nga pikëpamja e ndërtimit plastiko-ritmik qëndrojnë në mes të lëvizjeve të thjeshta dhe motivit «asimetrik» që përbën atë më të zhvilluarin në kërcimet e grave. Këto valle luhen më shumë në pjesën veriore (Tropojë) dhe në një farë mase edhe në krahun veriperëndimor të vendit (Mirditë, Pukë e Malësi e Madhe). Ato, për nga karakteri, përkohjnë edhe me trevën e Gjakovës (përtej kufirit të sotëm politik) dhe kjo vjen si rezultat i lidhjeve etnike dhe i shkëmbimeve ekonomike që kanë ekzistuar në të kaluarën.

Nga sa u tha më lart, këto kërcime janë dëshmi e vërtetë dhe rezultat i asaj jete shpirtërore të rënduar, që sundonte mbi gruan në të kaluarën. Prandaj, duke jetuar në këto kushte, horizonti i saj ishte i ngushtë, pra edhe krijimi i thjeshtë, i rëndomtë (veçanërisht për dy llojet e para). Përsa u përket llojeve, karakterit dhe strukturës në përgjithësi të valleve të grave, mendojmë se nga gjendja dhe shkalla e zhvillimit plastiko-ritmik, i përkasin një stadi të hershëm. Kjo për faktin se motivi «asimetrik», që në vallëzimin e grave përbën shfaqjen më të dukshme dhe paraqitet me ritëm të thjeshtë (i pandryshuar ritmikiisht, me përjashtim të rasteve të veçanta) dhe me një plastikë jo aq të zhvilluar (deri tek lëvizjet me ecje të zakonshme), është ndër më të vjetrit dhe luhet edhe në viset e tjera të Ballkanit, bile shkon deri në Karpatet. Pra duke u nisur nga fakti që këto motive paraqiten në një gjendje të tillë, me një ndërtim të thjeshtë dhe të shkallëzuar, supozimi mbi lashtësinë e tyre (në pamundësi për t'i periodizuar sot për sot), qoftë dhe në kuadrin ballkanik na duket i drejtë.

\* \* \*

Me çlirimin e atdheut u përmbys regjimi i vjetër dhe lindi pushteti i ri i demokracisë popullore, që hapi rrugën e ndërtimit të shoqërisë socialiste. Në këtë revolucion të madh mori pjesë edhe gruaja. «Çlirimi i gruas nga shtypja shekullore dhe dhënja e të drejtave të barabarta me burrit është një nga realizimet më të mëdha të Partisë sonë, një nga fitoret e shkëlqyera të popullit tonë»<sup>1</sup>.

Zhvillimi dhe thellimi i revolucionit ideologjik e kulturor dhe në veçanti lufta për emancipimin e plotë të gruas, përbëjnë sot një nga aspektet më të rëndësishme të revolucionarizimit të jetës sonë, ku një kontribut të madh po jep vetë gruaja shqiptare, tek e cila po lindin mendime, koncepte dhe tipare të botëkuptimit të ri socialist, që shfaqen duke lënë gjurmë në botën e saj shpirtërore, nëpërmjet formave të shumta të krijimtarisë popullore, ndërmjet të tjerash edhe të valles popullore.

Një tipar i rëndësishëm i këtij ndryshimi është dinamizmi, që sa vjen e po bëhet më i dukshëm në vallet e grave. Këto valle janë bërë sot më të gjalla dhe kërcyese, duke sjellë me vete edhe ndryshimin e përmbajtjes plastiko-ritmike. Gratë, veçanërisht vajzat, kërcëjnë më të lira, të qeshura dhe optimiste. Kënga me përmbajtje të re dhe shoqërimi orkestral (shpeshherë dhe të gërshtuar) po ndikojnë në zhvillimin dhe pasurimin shpirtëror të mendimit që shprehin këto valle. Një evolim i tillë është rezultat i ndryshimit të pozitës dhe rolit të gruas, vajzës, në jetë dhe në shoqëri, i pjesëmarrjes së tyre në manifestimet e mëdha shoqërore: festat lokale, kombëtare, festivalet folkloristike që tashmë janë bërë tradicionale tek ne etj.

Por ajo që shënoi kthesën, në kundërshtim me konceptet e vjetra zakonore, është dalja e gruas, vajzës, në valle të përbashkët me burrat, djemtë. Një fenomen i tillë u shfaq qysh gjatë Luftës nacionalçlirimtare, ku ideja e bashkimit për çlirimin e atdheut dhe revolucioni shoqëror që udhëhoqi Partia, i bashkoi të gjithë, burra e gra, si një trup i vetëm. Vallja «partizane», e cila u ngrit mbi bazën e motiveve popullore tradicionale, u bë simbol i bashkimit dhe i vëllazërimit për liri. Krijimi i valles «mikst» si fenomen i ri i krijimtarisë artistike është një ndryshim i madh cilësor në kushtet e shoqërisë socialiste; ai është rezultat i zhvillimit të mendimit shoqëror, i mbrojtjes të të drejtave të grave dhe i rolit të tyre në shoqëri. Këto forma të reja, do të përtërihen, do të përhapen dhe do të bëhen të ndërjegjshme, mbasi e tillë është edhe lufta jonë sot kundër çdo koncepti dhe mbeturine të vjetër reaksionare, që përligj poshtërimin e dinjitetit të gruas.

Nga pikëpamja koreografike krijimi i valles «mikst» po realizohet me futjen e djemve në kërcimet e grave dhe anasjelltas (më rrallë) për disa kërcime që kanë në bazë si motiv «trepashin popullor» të zhvilluar. Në të dy këto raste vallje «mikst» po shkon drejt zhvillimit të saj (qoftë dhe të ngadalshëm, nga që vallja është konservatore në natyrën e saj), si në drejtim të përmbajtjes, të dinamizmit, për rrjedhim edhe të formës koreografike, mbasi këtu kemi marrëdhënje djalë e vajzë. Këto forma të reja kërcimi janë vazhdimisht në përtëritje. Stili dhe përmbajtja e tyre po ndryshon në krahasim me natyrën dhe karakterin e po këtyre valleve, që janë praktikuar nga gratë në dasmat e dikurshme.

1) E. Hoxha, *Mbi problemin e gruas*, Tiranë, 1967, f. 101.

Populli ynë ruan në gjirin e tij valle të panumërta. Ato shprehin një përmbajtje të qartë, goftë dhe në mënyrë simbolike, që është kristalizuar në rrjedhën e shekujve. Kjo duket si në vallet e burrave dhe në ato të grave. Por populli ynë ka krijuar edhe valle që shprehin procese të drejtpërdrejta nga puna e përditshme. Një motiv i tillë i quajtur «valleja e punës» u shfaq nga valltarët e Zadrimës në festivalin folkloristik kombëtar të Gjirokastrës. Në këtë valle pasqyrohet thjesht, nëpërmjet këngës dhe lëvizjeve plastike, puna për mbjelljen e orizit, duhanit etj.

Vazhdimi dhe përpunimi i kësaj tradite po gjen pasqyrim më të dukshëm edhe në ditët tona, kryesisht në vallet e grave. Sigurisht, kushtet në të cilat jetojmë sot, karakteri i marrëdhnjeve të reja shoqërore dhe për pasojë, qëllimi i përbashkët për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste, janë faktorë që ndihmojnë për një pasqyrim më të qartë e më të plotë të aspekteve që kanë të bëjnë me temën e punës. Natyrisht, kjo duhet kuptuar në raport me shkallën dhe mundësitë shprehëse që ka arti i kërcimit.

Kështu, pasqyrimi i një mendimi të ri, ose i një përmbajtjeje të thjeshtë në formë fabule, gërshetuar nëpërmjet lëvizjeve karakteristike dhe origjinale, është bërë sot, më fort se kurrë, prirje zhvillimi. Kështu mund të përmendim vallen e «Endësve» kërcyer dhe interpretuar me mjeshtëri nga të rejat e katundit Kolesian të rrethit të Kukësit. Vallja u shfaq për herë të parë në festivalin folkloristik kombëtar të Lezhës më 1967. Ajo është ndërtuar në një koreografi të pasur, të larmishme në përputhje me ato forma pune që kërkon procesi i endjes, artistikisht të ngritur, dhe me një plastikë e ritëm të karakterit popullor. Kjo valle po përhapet dhe po zë një vend të merituar në repertorin tradicional të vallëzimit popullor të kësaj krahine. Të frymëzuar nga kjo, vajzat e Bicajt kanë krijuar vallen e «Tjerrjes së nortave» (fije leshi), dhe vallen «Korrja e misrit». Gjithashtu valltarët e reja të Matit, duke u bazuar në lëvizjet popullore, kanë krijuar vallen «Korrja e grurit» dhe vallen e «aksionit» etj. Këto krijime janë në zanafillën e tyre, ato vazhdimisht përpunohen, ripërtërihen dhe, duke ju nënshtruar ndikimit kolektiv, do të arrijnë shkallën e kristalizimit të tyre.

Evolucioni që po ndodh sot në vallet e grave është, — siç e theksuam edhe më lart, — rezultat i ndryshimit të kushteve dhe i marrëdhënjeve shoqërore, i mendimit të ri që po lind në kuptimin dhe në rolin e gruas në jetë e në shoqëri, si një nga objektivat kryesore të politikës së Partisë në revolucionin ideologjik e kultural. Qëllimi është që kjo lëvizje, për rigjenerimin dhe pasurimin e valles, të vazhdojë, të bëhet e ndërjegjshme dhe të përhapet kudo, jo vetëm si shprehje e së bukurës por si bartëse edhe e ndryshimeve të mëdha që po ndodhin sot në vendin tonë.

### R é s u m é

#### LA DANSE POPULAIRE COMME EXPRESSION DES SENTIMENTS ET DES OPINIONS DE LA FEMME DANS LA VIE SOCIALE

*Les auteurs parlent de la contribution qu'a donné la femme à la création de la danse populaire. Ils visent surtout à mettre en vue le degré du reflet des sentiments, des opinions et de sa condition dans la société.*

La femme chez nous, dans le passé, a été opprimée, abandonnée à son sort, à la merci de moeurs et coutumes atroces qui ont été en vigueur durant des siècles. La source de ces maux étaient les rapports sociaux tribalo-patriarcaux et féodaux. La religion et la domination étrangère ont concouru également à en faire un être claustré, piétiné, à porter atteinte à sa personnalité.

Quoique dans ces conditions, la femme a su produire plusieurs chansons sur la vie, les enfants, les noces. Au son de ces airs, elle a su aussi danser dans les chambres claustrées. Les danses étaient simples. Leur structure et leur contenu sont le reflet des sentiments et des opinions de la femme sur la vie sociale. Et cela est observé précisément dans les éléments composants des danses: les motifs chorégraphiques, le mode de traitement et de leur déplacement, dans l'interprétation et les caractéristiques en général. En dehors de l'aspect social, sur ces danses influent aussi d'autres facteurs comme le sont le terrain, le climat, l'habillement, etc.

Les auteurs croient que, malgré l'existence de tois genres plus ou moins différents, notamment pour ce qui est de l'interprétation, les danses féminines ont des points en commun. Le motif «asymétrique» constitue une de leurs manifestations principales. De même, caractéristiques sont encore d'autres motifs plus simples, qui au point de vue de leur construction plastique rythmique se situent au milieu des mouvements simples et du motif «asymétrique», qui constitue le degré le plus développé. Certains de ceux-ci se jouent d'une façon libre, ad libidum. Les danses des femmes sont exécutées en cercle clos de demi-ronde et en formation libre.

S'amorçant au fait que ces motifs se présentent dans un tel état, avec une construction simple et échelonnée, la supposition sur leur antiquité (dans l'impossibilité à les périodiser à l'heure que nous sommes) dans le cadre balkanique nous semble juste.

La victoire contre le fascisme et les oppresseurs du pays ouvre de grandes perspectives à la femme albanaise. Elle a lutté du même pied que l'homme. Le développement et l'approfondissement, de la révolution idéologique et culturelle, et notamment la lutte pour l'émancipation totale de la femme, constituent actuellement un des aspects les plus importants de la révolutionnarisation de notre vie. De nouvelles conceptions sont en train de se faire jour. Il s'agit de traits de la nouvelle conception socialiste. Elles laissent leur empreinte dans son monde spirituel aussi au travers les différentes formes de la création, et, entre autres, aussi de la danse populaire.

Un trait important de cette transformation est le dynamisme. Les danses des femmes sont devenues à l'heure que nous sommes plus vivaces, plus émotives. Le chant à nouveau contenu et l'accompagnement d'orchestre (souvent enchevêtré et compliqué) influent sur le développement et l'enrichissement spirituel de la pensée exprimée dans ces danses. La femme, la fille paysanne, participent actuellement à tous les domaines de la vie, et également aux fêtes locales et nationales, aux festivals folkloriques, etc.

Ce qui a marqué le tournant, en opposition aux conceptions anciennes, a été la création de la danse mixte. Un tel phénomène s'est manifesté déjà durant la lutte de libération nationale, et trouve actuellement un ample diffusion jusque dans les profondes contrées de montagne. Au point de vue chorégraphiques, la création de ces danses apporte quelque chose de nouveau dans le contenu et la forme, puisque, dans

ces cas, on a affaire aux rapports entre le jeune homme et la jeune fille. Ces formes de création sont en plein essor.

De même, le reflet d'une nouvelle pensée, ou bien d'un contenu simple sous forme de fabliau, enchevêtré au moyen des mouvements caractéristiques et originaux, est devenu à l'heure que nous sommes et plus que jamais, une tendance de développement. On peut mentionner à cet effet: la «Danse des fileuses», la «Danse des fileuses de noeuds de moquettes» (Kukës), la «Danse des moissons», la «Danse de l'action» (Mati), etc. Ces créations sont à leurs premiers pas. Elles se renouvellent sans cesse, en se soumettant à l'influence collective, jusqu'à arriver à leur cristallisation. Le but est que ce mouvement tendant au reflet des nouvelles conceptions dans les danses se continuât, qu'il devienne conscient et soit diffusé partout, non seulement comme une extériorisation du beau mais aussi comme porteur des grandes transformations qui ont lieu dans notre pays.